



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## Njoftim Publik

Në drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar aplikacioni **05 nr.350/02 – 122067/21 dt.28.06.2021**, në emër të pronarëve: Ymer Sylja, Fatmir Shaqiri, Ismet Shaqiri, Shefqet Jusufi dhe Agim Jusufi dhe Investitorit "Cima"sh.p.k. nga Fushe Kosova, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimore / projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste – Ndërtesa -2B+S+P+11, në kuadër të Bllokut urban "b\_09", Tërësia "B-2" të Planit Rregullues "Muhaxheret" në Prishtinë, konkretisht parcelave: nr.2671-4, 2671-6, 2671-7, 2671-12, ZK Prishtinë, sipas projekt propozimit / Planit të situacionit - "zgjidhjes urbane" të prezantuar.

Bazuar në pikën 2 të nënit 18 të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, "Organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së lejes së ndërtimit". Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **23.08.2021** deri me datën **06.09.2021** në Email adresën: [urbanizmprištine@rks-gov.net](mailto:urbanizmprištine@rks-gov.net)

Kushtet e propozuara: Ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa -2B+S+P+11	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Tokë bujqësor / "Arë e Klasës 1, 6, 5" – Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	E përcaktuar me profilin e planifikuar të rrugës publike
c. Vija ndërtimore	E përcaktuar me profilin e planifikuar të rrugës publike nga vija rregulluese
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	41.75 m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	Anësor: 41.75/8.00m' & 7.01/25.48m' Pasmë : 41.75m'/7.18m' & 7.02/40.75 m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	~40%- lejuar
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	ISD-4.0
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	ISGH~ 50%,
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	ISHB~60%
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	Sipas kritereve të planit
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet tuaja duhet të përkrahjet numri i kërkesës të shënuar më lartë.

Nënshkrimi i Zyrtarit:

